



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Në mbështetje të nenit 15.2 të Ligjit Nr. 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 5, 6 dhe 7 të Rregullores (ZKA) 01/2024 për Pranimin dhe Karrierën në Zyrën Kombëtare të Auditimit, lidhur me nenin 36 të Rregullores (ZKA) 03/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës; Planit Vjetor të Rekrutimit për vitin 2025 si dhe Vendimit të Auditorës së Përgjithshme me Nr.275 dhe nr. 313 për plotësimin e vendit të lirë të punës, Zyra Kombëtare e Auditimit shpall:

KONKURS

për plotësimin e vendit të lirë të punës

Pozita: Këshilltar Juridik për Çështje Juridike dhe Përfaqësim Gjyqësor
Numri i referencës: KJPGJ/ZKA/06-03/25
Grada: ZKA-X2
Numri i pozitave: Një (1)
Kohëzgjatja e emërimit: Me kohë të pacaktuar

Detyrat Kryesore:

1. Ofron këshilla profesionale, opinione ligjore dhe rekomandime gjatë auditimeve financiare dhe të pajtueshmërisë sipas akteve të brendshme, udhëzuesve dhe doracakëve në fuqi;
2. Merr pjesë në auditimet e pajtueshmërisë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA), legjislacionit në fuqi dhe akteve të brendshme të ZKA-së dhe mbështet ekipet e auditimit, sipas kërkesës;
3. Ofron asistencë ligjore dhe udhëzon ekipet e auditimit për çështjet e pajtueshmërisë;
4. Shfrytëzon njohuritë juridike për të dhënë këshilla të sakta në lidhje me përputhshmërinë ligjore gjatë auditimit, si dhe për të identifikuar rreziqet dhe shkeljet potenciale;
5. Siguron shkrim të rrjedhshëm të dokumenteve të punës për pajtueshmëri duke nxjerr konkluzione këshilla/rekomandime të qarta për çështjet e trajtuara që mund t'i ndihmojnë ekipit të auditimit;
6. Merr pjesë në hartimin e akteve juridike, dokumente strategjike, marrëveshje bashkëpunimit dhe akteve tjera nga fushëveprimtaria e ZKA-së, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me dispozitat kushtetuese, legjislacionin në fuqi dhe SNISA-t, dhe respekton teknikat dhe standardet e hartimit sipas legjislacionit në fuqi;
7. Mbikëqyrë zbatimin e akteve juridike të ZKA-së, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi dhe SNISA-t. Identifikon zbrazëtirat juridike, mangësitë dhe vështirësitë në zbatimin e tyre, si dhe propozon ndërmarrjen e masave konkrete për përmirësimin e situatës;
8. Përfaqëson dhe/ose bashkëpunon me strukturat institucionale në përfaqësimin ligjor të ZKA-së, si dhe trajton ankesat dhe parashtrësat nga Gjykatat e Republikës së Kosovës dhe institucioneve të tjera relevante;
9. Publikon aktet nënligjore të ZKA-së në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe përditëson regjistrin e ankesave dhe parashtrësave, si dhe
10. Kryen detyra tjera të përcaktuara me legjislacionin në fuqi dhe të ngarkuara nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë apo i niveleve tjera më të larta në hierarki.

Kërkesat e përgjithshme formale, janë:

- Arsimimi: Diplomë të fakultetit juridik;
- Përvoja profesionale: Tre (3) vite përvojë pune profesionale në çështje juridike, administratë apo auditim.

Shkathësitë e kërkua:

- Njohuri dhe përvojë në hartimin, harmonizimin e legjislacionit dhe akteve tjera juridike.
- Njohuri të akteve juridike të aplikueshme në Zyrën Kombëtare të Auditimit.
- Shkathësi në komunikim dhe planifikim të punës.
- Shkathësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale.
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion.
- Shkathësi kompjuterike të aplikacioneve të programeve (Word, Excel, Power Point).

Informata të përgjithshme për kandidatë:

Përcaktimi i pagës bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Procedura e Aplikimit:

Procedura e aplikimit është e hapur për të gjithë kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Zyra Kombëtare e Auditimit ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret kandidatët nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë dokumentet e nevojshme, si më poshtë:

- formularin zyrtar të ZKA-së për aplikim;
- kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
- dëshmitë për përgatitjen arsimore (Diplomë fakulteti). Diplomat e fituara jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara;
- dëshmitë për përvojën e punës (Kontratë Pune ose Vërtetim i Marrëdhënies së punës, të shoqëruara me dëshmi nga Trusti);
- dëshmia nga gjykata që nuk është i dënuar me vendim të formës së prerë (jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- dëshmia që nuk ka në fuqi masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik (*nëse aplikohet*);

Vetëm formulari zyrtar për konkurrim do të merret parasysh. Dokumentet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk shqyrtohen kurse ato të pakompletuara do të refuzohen. Vetëm kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret do të kontaktohen. Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në mediat elektronike (*online*) dhe në faqen e internetit të Zyrës Kombëtare të Auditimit. Afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data **11.04.2025 ora 16.00**.

Formularët për aplikim mund të merren në recepcionin e ZKA-së, ose mund të tërhiqen nga faqja e internetit e ZKA-së në adresën www.zka-rks.org dhe dorëzohen në Divizionin për administrimin e dokumenteve në adresën: Lagja: Arbëria, rr. "Ahmet Krasniqi" nr. 210 – Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 – 16:00, formulari dhe dokumentet mbështetëse mund të dorëzohen edhe përmes adresës elektronike në adresën rekrutimi@oagks.org ose përmes postës. Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në nr.tel. 038/606-004, ext:1025.

Shënim:

Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim.